





Ne pozicionin e drejtueses ekzekutive te FSHDPAK, kam kenaqesine te prezantoj raportin e aktivitetit te kesaj organizate per vitin 2005.

Ky botim eshte nje permbledhje e shkurter e disa prej aktiviteteve dhe arritjeve kryesore te FSHDPAK.

Raporti pasqyron progresin dhe rezultatet e arritura ne bashkepunim me partneret dhe bashkepunetoret e FSHDPAK ne te gjitha nivelet.

Do te doja te theksoja se viti 2005 ka qene nje vit perpjekjesh, arritjesh pozitive ne drejtim te mbrojtjes te se drejtave, permiresimit te cilesise se jetes per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

Do te doja te pershendesja perpjekjet dhe perkushtimin e te gjithe ekipit te FSHDPAK ne realizimin me sukses te objektiveve tona per vitin 2005.

Blerta ÇANI
Drejtoresh Ekzekutive

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Blerta Çani'.

Permbajtja

PERSHENDETJE NGA DREJTORI EKZEKUTIV I FSHDPAK	1
VITI 2005- VITI I APROVIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË AFTËSISË SË KUFIZUAR NGA QEVERIA SHQIPTARE	2
STRUKTURA E PROGRAMIT TE FSHDPAK	
PROJEKTET E FSHDPAK PER VITIN 2005	5
• Qendër burimore për te drejtat e aftësisë së kufizuar	6
• Avokati dhe asistencë ligjore falas për personat me aftësi të kufizuar	11
• Media dhe aftësia e kufizuar	14
• Shërbime mbështetëse për njëzëzit me aftësi të kufizuara në nevojë për karrikerë me rrota në Shqipëri	18
• Burime të tjera lokale të cilat kanë mbështetur dhe siguruar qëndrueshmëri të aktivitetit të punishtës “Miresia”	22
• Për një rol më aktiv të shoqërisë civile në zbatimin e SKAK.	24
• Pjesëmarrja në proceset zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar	26
• Procesi i vëzhgimit zgjedhor nga zgjedhësit me aftësi të kufizuar	28
PUBLIKIME TE FSHDPAK. QENDRA BURIMORE E AFTËSISË SË KUFIZUAR	30
INFORMACION FINANCIAR	31
STRUKTURA VENDIMARRESE DHE ADMINISTRATIVE	33
PLANIFIKIMI STRATEGJIK I FSHDPAK 2006-2009	34

Viti 2005- Viti i aprovimit të Strategjisë Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar nga Qeveria Shqiptare

Me 7 Janar 2005, Keshilli i Ministrave, miratoi Strategjine Kombetare te Personave me Aftesi te Kufizuar. U finalizua keshtu faza e pare e procesit te ndermarre nga Grupimi i Shoqatave prane FSHDPAK per te nxitur qeverine per perfshirjen e problematikave te aftesise se kufizuar ne axhenden e saj.

Strategjia Kombetare e PAK perben programin e Qeverise Shqiptare qe synon permiresimin e jetes se njerezve me AK duke zhvilluar politika dhe programe te reja si dhe pershtatur politikat dhe programet egzistuese me standartet nderkombetare te Kombeve te Bashkuara, Keshillit te Europes dhe Bashkimit European. SKPAK perben nje dokument ligjor(Vendim i KM Nr 8, date 7 Janar 2005) qe percakton objektivat qe do te arrihen ne periudhen 2004-2014 si dhe pergjegjesite respektive te pushtetit qendror dhe lokal ne permbushjen e detyrave specifike te nevojshme per realizimin e ketyre objektiveve.


Ndryshimet politike pas zgjedhjeve te 3 Korrikut, 2005, rikonfirmuan dhe njehere besimin e organizatave ne fushen e te drejtave te AK, pasi qeveria e re tregoi nje qendrim pozitiv ndaj ceshtjeve te AK.

Megjithate, organizatat e fokusuara ne fushen e te drejtave te AK, te cilat ne menyre aktive bashkepunuan gjate tre viteve te fundit per hartimin dhe nxitjen e procesit te aprovimit te strategjise, ende vene re se ritmet e zhvillimeve ne fushen e AK jane shume te ngadalta.



Njerezit me AK vazhdojne te perjetojne diskriminim, varferi ekstreme, perjashtim social. Ndaj FSHDPAK dhe organizatat e njerzve me AK, shprehin shqetesimin e tyre dhe u vazhdojne te nxisin te gjithë aktoret te kuptojne rëndesine e pershpjtitimit te procesit te implementimit te strategjise kombetare te aftesise se kufizuar, njekohesisht konfirmojne dhe njehere vendosmerine e tyre per te vazhduar procesin e avokatise dhe monitorimit te respektiomit te te drejtave te njerezve me AK ne Shqiperi.

Struktura e programit të FSHDPAK



Projekte të FSHDPAK, 2005





TITULLI I PROJEKTIT

**QENDËR BURIMORE PËR TE DREJTAT E
AFTËSISË SE KUFIZUAR**

DONATOR: CORDAID

NUMRI I PROJEKTIT: 432/10033/ CORDAID

PERIUDHA: 1 Mars 2005 - Dhjetor 2005

BUXHETI: 90053 EURO

Me mundësitë e reja të financimit të CORDAID për Qendrën Burimore për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar, programi ka interesa që gradualisht e natyrshëm fokusohen dhe kanë prioritet njerëzit në aftësi të kufizuara mendore dhe intelektuale në mënyrë që të trajtohen pabarazitë që ata ndeshin me pjesën tjetër të shoqërisë por gjithashtu brenda grupeve të aftësisë së kufizuar.

Projekti synon të fuqizojë njerëzit me aftësi të kufizuara fëmijët e tyre kujdestaret specialistet duke u ofruar një qendër trajnimi dhe shërbim informacioni duke rritur në të njëjtën kohë ndërgjegjësimin vendor dhe kombëtar, lobingun dhe avokatinë në komunitet dhe në nivel qeveritar në mbështetje të zhvillimit të procesit të përfshirjes së plotë të njerëzve me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare.

Ndërhyrjet e realizuara në emër të projektit kanë kontribuar për rezultate të dallueshme:

I- Fuqizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve kryesisht për individët me aftësi të kufizuara, organizatat e aftësisë së kufizuar dhe për çdo njeri që përfshihet në fushatat dhe që

përgjigjet gjithashtu për zhvillimin, përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe shërbimet për njerëzit me aftësi të kufizuara, nëpërmjet rritjes konstante të shërbimit të Qendrës Kombëtare të Trajnimit dhe Informacionit të FSHDPAK në Tiranë.

- 1- Dy libra udhëzues që fokusohen në aftësinë e kufizuar intelektuale, janë përgatitur, botuar në 500 kopje secili, janë shpërndarë dhe vënë në dispozicion veçanërisht prindërve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes dhe të mësuesve:
 - a) Një udhëzues për të ndihmuar prindërit gjatë procesit të rritjes së një fëmijë me aftësi të kufizuara,
 - b) Një udhëzues për të ndihmuar mësuesit që të realizojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në një mjedis përfshirës.
- 2- Informacion për aftësinë e kufizuar, statistikën, shërbimet, grumbullohen rregullisht duke pasuruar shërbimin e informacionit të FSHDPAK. Biblioteka e FSHDPAK numëron 891 tituj.
- 3- Publikimet e FSHDPAK për aftësinë e kufizuar (flete informacioni, libra, fletëpalosje, studime, etj.) janë rritur me 20 publikime në vitin 2005, duke rritur një shifër totale 115.
- 4- Faqja e Internetit e FSHDPAK ofron një alternativë tjetër për të gjetur informacion për aftësinë e kufizuar në Shqipëri.
- 5- Shërbimi i Informacionit është vënë në dispozicion të klientëve në zyrat e FSHDPAK, me një total prej 1700 njerëzish. Këshillimi mbi bazat e të qenurit në pozitë të barabarta, orientimi, këshillim dhe asistencë teknike dhe ekspertiza për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të aftësisë së kufizuar janë vënë në dispozicion të klientëve të FSHDPAK.

II- Kapacitetet për Aftësinë e Kufizuar dhe çështjet e Barazisë janë rritur gjatë vitit 2005 nëpërmjet kryerjes së trajnimeve intensive.

- 1- Manuali për Aftësinë e Kufizuar dhe Barazinë u pasurua, azhurnua, u testua në terren me grupet kyçe të trajnerëve të FSHDPAK dhe u publikua duke u vënë në dispozicion për përdorim në sesionet e ndryshme të trajnimit të organizuara gjatë gjithë vitit.
- 2- Sesionet e trajnimit të organizuara gjatë vitit patën si objektive grupet e ndryshme në 6 rrethe.

Çështjet e trajnimit	Grupi objektiv	Numri i trajnimeve	Numri i përfituesve	Shtrirja gjeografike
Modelet e Aftësisë së Kufizuar, te drejtat e Aftësisë se Kufizuar dhe Legjislacioni	Organizatat Aftësisë së Kufizuar	6	120	Tirana, Durrësi, Vlora, Elbasan, Korça dhe Shkodra:
Modelet e Aftësisë së Kufizuar, te drejtat e Aftësisë se Kufizuar dhe Legjislacioni, me fokus në Strategjinë Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar	Qeveria Vendore	6	110	Tirana, Durrësi, Vlora, Elbasani, Korçë dhe Shkodra:
Pershtatshmeria dhe projektimi per te gjithë	Zyrtaret e Qeverise Vendore te zyrave te planifikimit urban	6	74	Korçë, Shkodra, Lezha, Berat, Fier, Pogradec
TOTALI		18	204	

III- Lobing dhe avokati konstante e kryer për te siguruar, hartuar dhe zbatuar politika dhe legjislacion mosdiskriminues dhe shanse të barabarta për pjesëmarrje të njerëzve me aftësi të kufizuar.

1- Ne janar te vitit 2005, me Vendimin e Këshillit te Ministrave u miratua Strategjia Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar (SKAK). FSHDPAK ishte aktori kyç qe inicioi, koordinoi te gjithë aktorët, ofroi ekspertize konstante, si dhe zhvilloi avokati te vazhdueshme për miratimin e këtij dokumenti politik.

Gjatë vitit 2005 FSHDPAK zhvilloi strategji për të stimuluar zbatimin e SKAK.

- i) kontakte konstante, këshillime dhe ekspertize për te gjithë institucionet përgjegjëse qeveritare dhe joqeveritare për zbatimin e SKAK. (12 ministri të linjës dhe institucione, dhe të paktën 22 organizata për aftësinë e kufizuar.
- ii) Rrjet i zgjeruar dhe avokati në nivelin e qeverisë vendore, (7 ndarje rajonale).
- iii) Një dialog eficient i ndërtuar dhe i mirëmbajtur me Qeverinë e Re te zgjedhur pas zgjedhjeve parlamentare te qershorit 2005. Kontakte te vazhdueshme me zyrtaret më të lartë te të gjithë ministrive te linjës, veçanërisht me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, si Ministria kryesore përgjegjëse për politikat e aftësisë së kufizuar, kane stimuluar lëshimin e mjaft dokumenteve zyrtare, vendimeve te qeverise që do të kontribuonin në zbatimin e SKAK. Dy Vendime te Këshillit te Ministrave u morën ne dhjetor 2005, a) Për

Krijimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, b) Për Krijimin e Grupit te Punës për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Aftësinë e Kufizuar me synimin për të hartuar një ligj integral.

- iv) Përpjekjet e avokatisë së FSHDPAK te fokusuara në stimulimin e përfshirjes së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe organizatave të tyre përfaqësuese në procesin e vendimmarrjes, rezultuan në caktimin e 4 organizatave të aftësisë së kufizuar në dy grupe pune ndërministrorë, Këshillin Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Grupin e Punës që rishikon legjislacionin për aftësinë e kufizuar.

2- Përpjekjet e avokatisë së FSHDPAK për të siguruar implementimin e legjislacionit për pershtatshmerine dhe arsimimin përfshirës kanë përfshirë por nuk janë kufizuar vetëm me:

- Dialogun e mbajtur me zyrtarët me të lartë qeveritare përgjegjës në nivelin qendror dhe vendor dhe profesionistët përgjegjës për zbatimin e normave të urbanistikës për pershtatshmerine
- Kapacitetet e krijuara nëpërmjet sesioneve të trajnimit të organizuara (shih 2 me sipër) për pershtatshmerine e mjedisit të ndërtuar;
- Çështjet e transportit të përshtatur/arritshëm, si kuadri ligjor i paplote në fushën e aksesit dhe shërbimeve të transportit dhe të telekomunikacionit për personat me aftësi të kufizuar, duke përfshirë transportin rrugor, transportin hekurudhor, transportin ajror, transportin detar, etj., u diskutuan gjerësisht në një seminar të organizuar me pjesëmarrjen e 35 pjesëmarrësve, zyrtarë vendimmarrës ose specialistë nga zyrat përgjegjëse qeveritare qendrore dhe vendore, MÇSSH, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Rregullimit të Territorit, Bashkia e Tiranës, institucione të tjera publike ose private, organizata të AK, etj. Rekomandime të dobishme dhe përgjegjësi konkrete u ndërmorën nga pjesëmarrësit, FSHDPAK do të vazhdojë të nxisë implementimin e tyre.
- Ekspertiza dhe kontaktet e mbajtura me Universitetin e Tiranës/Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit për të siguruar që, krahas çështjeve të veçanta të paraqitura tashmë në lidhje me arritshmërinë,/pershtatshmerine të ndërtohen modele të programeve mësimore të standardizuara për aftësinë e kufizuar.

3- Në Mars 2005 FSHDPAK finalizoi raportin mbi kërkimin e kryer ‘Një Rast Studimor i Bazuar tek Fuqitë’, i fokusuar në përvojën unike të arsimit përfshirës me fëmijët me aftësi të kufizuar në Librazhd. I dokumentuar dhe i analizuar mirë, informacioni në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për arsim përfshirës në formën e një raporti kërkimor gjithëpërfshirës është në dispozicion për tu përdorur. Ky raport ka në përbërje konstatime të dobishme dhe rekomandime për institucionet qeveritare dhe joqeveritare agjencitë donatore etj.

IV- Një program intensiv edukimi qytetar që promovon barazinë dhe përfshirjen e plote të PAK ka përfshirë ndërhyrje të shumta, i realizuar kryesisht në emër të projektit ‘Për Median dhe Aftësi e Kufizuar’.

1- Ndërhyrja kryesore e realizuar në kuadrin e Qendres Burimore ka konsistuar në përpjekjet për të stimuluar MASH për të siguruar standardizimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe barazisë në programet shkollore. Në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik dhe organizata të tjera të interesuara, që fokusohen tek të drejtat e fëmijëve, të drejtat e grave, të drejtat e Romeve, etj., FSHDPAK ka dhënë kontributin e vet për të realizuar një program ndërveprues (kroskurrikul) që është i disponueshëm për përdorim nga të gjithë shkollat e arsimit

2- Një lëndë për Aftësinë e Kufizuar dhe Barazinë është futur nga FSHDPAK në Universitetin e Vlorës në Degën që përgatit specialistët për aftësinë e kufizuar. FSHDPAK gjithashtu ofron leksionet për këtë lëndë.

Përveç investimit të jashtëm, FSHDPAK ka investuar brenda organizatës si një mjet shumë i dobishëm për sigurimin e rritjes së cilësisë së shërbimit si dhe të kontributit për vazhdueshmërinë dhe gjetjen e fondeve. Stafi i FSHDPAK ka marrë pjesë aktive në seminare, workshope, aktivitete trajnuese të ndryshme në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2005, FSHDPAK përgatiti planifikimin e tij strategjik për vitet 2006-2009, si një dokument madhor politik, i cili përcakton drejtimit kryesor që do të ndiqen duke kontribuar në përmbushjen e misionit kryesor të organizatës.





TITULLI I PROJEKTIT

AVOKATI DHE ASISTENCE LIGJORE FALAS PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR

DONATORI: KOMITETI SUEDEZ I HELSINKIT PER TE DREJTAT E NJERIUT
PERIUDHA E ZBATIMIT: JANAR 2005-JANAR 2006
BUXHETI: 29,920 EURO

FSHDPAK ka inicjuar prej muajit Shtator 2004 Programin “Avokati dhe Asistencës Ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuar”, me veprimtari në qytetet Tiranë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Durrës, Vlorë, projekt i financuar nga **Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**.

Ky program ka si mision mbrojtjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK), përmirësimin e kuadrit ligjor, dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Personat me Aftësi të Kufizuar kanë mungesë totale informacioni mbi të drejtat që Ligji u garanton, mbi procedurat që duhet të ndjekin dhe Institucionet ku duhet të drejtohen për të kërkuar të drejtat e tyre.

Në këte kuader, Programi Ligjor përmes 7 Avokatëve dhe Juristëve asiston dhe ofron çdo ditë, në Tiranë dhe 5 rrethe të vendit, këshillim dhe asistencë ligjore për të gjithë PAK dhe familjarët tyre. Përfaqëson ligjërisht PAK në mbrojtje të të drejtave të


tyre përpara institucioneve të Administratës Publike. Kur konstatohet shkelje e ligjit, abuzimit dhe mosbatimit të tij, PAK apo familjarët e tyre përfaqësohen ligjërisht nga Avokatët e këtij programi në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.

Gjatë vitit 2005 Zyra ligjore ka trajtuar një numër total rastesh, nga ku 360 PAK nga Tirana dhe 234 nga 5 qytetet, Vlora Durrësi, Shkodra, Elbasani dhe Korça.

Nga këto 165 raste administrative janë ndjekur në Tiranë dhe 105 janë ndjekur nga Avokatët në 5 qytetet e tjera.

Përfaqësimi ligjor në sistemin gjyqësor është ofruar për 5 raste në Tiranë, 2 në Elbasan, 1 në Vlorë.

Rastet gjithsej për vitin 2004–2005, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtëme;



Publikime

Gjatë vitit 2005, Zyra Ligjore ka publikuar dy guida udhëzuese “Mbi ligjin për sigurimet shoqërore në RSH” dhe “Mbi Statusin e Invalidit të Punës”. Guidat udhëzuese së bashku me Paketën Ligjore mbi aftësinë e kufizuar (publikim i cili përmbledh gjithë paketën ligjore që vepron në RSH) ia vene ne dispozicion si individëve ashtu edhe organizatave të personave me aftësi të kufizuar.

Përreth 320 fletëpalosje, 400 paketa ligjore, 250 guida udhëzuese janë shpërndarë në të gjithë rrjetin bashkëpunues të FSHDPAK, në klientët që asistohen në zyrat tona dhe në institucionet publike.

Përfshirje në ndryshime ligjore

Zyra Ligjore ofron dhe asiston me ekspertizë ligjore, në bashkëpunim me Programin e Avokatisë, Qeverinë Shqiptare në të gjitha ndryshimet apo përmirësimet ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar, si dhe asiston me ekspertizë ligjore Shoqata që ndërmarin iniciativa ligjore në këtë fushë.

Në Mars 2005, në bashkëpunim me Grupin e Shoqatave të Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Intelektuale, në mënyrë të veçantë të shoqates “MEDPAK”, “Ndihamoni Jeten”, por edhe Organizatave të tjera Kombëtare apo Lokale (anëtare të rrjetit të Fondacionit), si dhe të një numri të madh klientesh të asistuar nga Programi Ligjor, ADRF luajti një rol të rëndësishëm në propozimin e disa ndryshimeve në draft-ligjin “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”. Falë kësaj ndërhyrje neni 25 i ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 garanton të drejtën e aplikuesit të pagësës të aftësisë të kufizuar për ankimim në gjykatë, e drejtë e cila nuk ishte parashikuar në ligjin e mëparshëm.

Gjate vitit 2005, Zyra Ligjore e FSHDPAK nenshkroi një marrveshjeje bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Popullit. Marrveshja synon të institucionalizojë bashkëpunimin në lidhje me referimin e rasteve të PAK për të cilat lind nevoja për mbrojtje avokatore në sistemin gjyqësor si dhe lehtësirave të cilat mund të realizohen në komunikimin shkresor me administratën publike në funksion të zgjidhjeve të problematikave të PAK.

Bashkëpunimi me median

Zyra ligjore ka bashkëpunuar ngushtësisht me median si të shkruar dhe elektronike për bërjen publike të të gjitha rasteve në të cilat janë konstatuar shkelje e të drejtave dhe diskriminim i PAK. Në një numër të konsiderueshëm artikujsh vend të rëndësishëm kanë zënë nxjerrja në pah e problematikave që hasin PAK në çdo aspekt të jetës së tyre, si mosgarantimi i të drejtës për arsimimin gjithëpërfshirës, të drejtës për strehim, të drejtës për punësim dhe të sigurimit të një standarti minimal jetese., si dhe mangësive ligjore.

Që prej muajit Shtator 2005, Programi Ligjor, për t’i ardhur në ndihmë PAK dhe familjarëve të tyre, ka realizuar, në kanalën e parë të Radio Tiranës, transmetimin e emisionit “Ligji, sa e njohim dhe sa e zbatojmë atë”. Emisjoni ka për qëllim dhënien e informacionit dhe shpjegimin e ligjeve të aftësisë të kufizuar të cilat veprojnë në RSH, por njëkohësisht përmes tij, ofrohet konsulencë ligjore direkte telefonuesve nga qytete të ndryshme të Shqipërisë.



TITULLI I PROJEKTIT | **MEDIA DHE AFTESIA E KUFIZUAR**

DONATORI: KOMITETI SUEDEZ I HELSINKIT PER TE DREJTAT E NJERIUT

PERIUDHA E ZBATIMIT: JANAR 2005-JANAR 2006

BUXHETI: 34,915 EURO

“Media dhe Aftesia e Kufizuar”, projekt i cili ka synuar te luftoje diskriminin dhe te promovojte shanse dhe alternativa per personat me aftesi te kufizuar permes mjeteve dhe menyrave te edukimit qytetar. Kete qellim ne fushen e medias projekti e ka realizuar duke influencuar ne ndryshime ne sektorin e medias si ne nivel te politikave ashtu edhe ate praktik per nje prezantim sa me dinjitoz te personave me aftesi te kufizuar ne media duke siguruar ne te njejten kohe ndryshime pozitive te qendrimeve te mbare shoqerise shqiptare per kete kategori.

Edhe gjate vitit 2005 projekti ka mundesuar permes aktiviteteve te realizuara te rrise ne shkalle te ndjeshme ndergjegjesimin e strukturave te medias per problematiken e aftesise se kufizuar dhe permes tyre te mundesoje informim te gjere te opnionit publik per keto çështje.

Projekti Media dhe aftesia e kufizuar si vazhdimesi i projektit te meparshem ka thelluar bashkepunimin me rrjetin e gazetareve dhe mediave te identifikuar per te krijuar hapsira dhe kendveshtrime te reja ne mediat e shkruara dhe elektronike per aftesine e kufizuar. Risia qe ky projekt solli ne dy vite ne Shqiperi per perfshirje te medias ne trajtimin e duhur te çështjeve te aftesise se kufizuar e ben ate nje faktor te rëndesishem ne ndryshimin pozitiv te qendrimeve te mbare shoqerise shqiptare per kete problematike.

Aktivitetet e kryera gjate vitit 2005 mbeshtetur ne objektivat e projektit kane mundesuar rezultate te tilla si:

1. **Ndergjegjesim i strukturave pergjegjese** permes takimeve dhe negociatave, Komisionit Parlamentar te Medias per perfshirje ne Ligjin e Medias te ceshtjeve te aftesise se kufizuar duke mundesuar prezantim cilesor dhe sasior te ketyre ceshtjeve ne median e shkruar dhe elektronike.
2. **Krijimi i hapsirave te reja**, perfshirja ne programe te ndryshme e ceshtjeve te aftesise se kufizuar, nje mbulim i gjere dhe me profesionalizem i kesaj problematike nga TV Publik Shqiptar. Ky rezultat u mundesua nga negociata dhe marreveshje me drejtues te ketij televizioni.
3. **Ndergjegjesim i organizatave te mediave** ne Shqiperi per perfshirje te Kodit te Etikes se Aftesise se Kufizuar ne Kodin e Etikes se Medias. Kjo eshte vleresuar nga gazetaret profesioniste si domosdoshmeri ne kushtet e hartimit te nje Kodi Etik per gazetaret ne Shqiperi.
4. **Perfshirja ne programet e fakultetit te gazetarise te ceshtjeve te aftesise se kufizuar**, specifikisht ne lenden e etikes se gazetarit, duke influencuar ne formimin e gazetareve te ardhshem profesioniste me koncepte bashkekohore te trajtimit te ceshtjeve te aftesise se kufizuar.
5. Organizimi dhe finalizimi me sukses i javes se aftesise se kufizuar **“Pa barriera”**. Zhvillimi i nje aktiviteti te tille mundesoi evidentimin e problematikes se aftesise se kufizuar mbeshtetur edhe ne objektivat themelore e Strategjise Kombetare per Aftesine e kufizuar te tilla si: arsimi, shendetesia, sherbimet sociale dhe pershtatshmeria duke terhequr vemendjen per nxitje te zbatuesmerise se politikave dhe kuadrit ligjor per respektim te te drejtave te personave me aftesi te kufizuar. Kjo jave u zhvillua ne Tirane dhe ne 5 qytete te tjera te vendit, si; Vlore, Shkoder, Durres, Elbasan dhe Korçe. Çdo dite e kesaj jave iu kushtua nje problematike te caktuar per aftesine e kufizuar; legjislacioni, pershtatshmeria, arsimi, shendetesia. Aktivitetet e kesaj jave u zhvilluan me pjesmarrjen e stafit te FSHDPAK, studente vullnetare, aktive prane FSHDPAK, individe me aftesi te kufizuar. Aktiviteti i çdo dite u realizua prane institucioneve te cilat jane pergjegjese per zbatimin e politikave dhe sherbimeve si dhe per ofrimin e tyre. Pjesmarresit ne aktivite te veshur me simbolet e javes shperndane per perfaqesuesit e ketyre institucioneve si; deputeteve te Kuvendit te Shqiperise, stafit drejtues, personelit mjekesor, te semureve e familjareve te tyre , studente te mjeksise prane QSUT; pedagoge e studente te Fakultetit te Ndertimit, mesues dhe nxenes te shkollave te mesme te pergjithshme materiale informuese per zbatimin dhe respektimin

e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi. Te njezat aktivitetet u zhvilluan edhe ne 5 qytete te tjera prane institucioneve lokale pergjegjese per problematiken e aftesise se kufizuar.

Kjo jave u pasqyrua gjeresisht ne median e shkruar dhe elektronike.

6. **Ngritja ne vazhdimesi e kapaciteteve te rrjetit te gazetareve** te identifikuar dhe pasurimi i ketij rrjeti me gazetare te rinj. Gjate ketij viti jane zhvillur 6 trainime 2 ditore ne 6 rrethe te vendit Tirane, Durres, Elbasan, Korçe, Shkoder dhe Gjirokaster me rrjetin e gazetareve te krijuar. Ne keto trainime kane perfituar rreth 105 gazetare nga media te shkruar dhe elektronike, te mediave publike lokale dhe kombetare. Trainimet e kryera kane patur si qellim informimin e gazetareve me kuadrin politik dhe legjislativ kombetar dhe nderkombetar per aftesine e kufizuar. Keto trainime te zhvilluara ne vazhdimesi kane mundesuar rritje te njohurive dhe formim sa me te plote te gazetareve per trajtimin e ceshtreve te aftesise se kufizuar.
7. **Rritja e cilesise se revistes “ Sfida “, botim periodik i FSHDPAK.** Kjo eshte realizuar permes rikonceptimit te rubrikave te saj, duke perfshire rubrika te tilla si; dokumenta nderkombetare, artikuj te gazetareve te trainuar, tregime te personave me aftesi te kufizuar si dhe nje rubrike argetimi e gatimi. Per here te pare kete vit “ Sfida “ ka patur te perfshire nje artikull te perzgjedhur ne BRAIL. Kjo ka mundesuar rritjen e aksesit nga personat e verber per kete botim. Revista “ Sfida” eshte botuar tre here ne vit ne 500 kopje per secilin numer te saj.
8. **Informacioni i vazhdueshem per aftesine e kufizuar** qe i eshte ofruar gazetareve dhe opinionit me gjere, botime, deklarata per shtyp, pergatitja dhe shfaqja e nje spoti, pergatitja dhe transmetimi i nje dokumentari per personat me aftesi te kufizuar, kane krijuar mundesi per te ngritur kapacitetet e tyre ne drejtim te prezantimit te duhur te ceshtjeve te aftesise se kufizuar dhe individeve me aftesi te kufizuar ne median e shkruar dhe elektronike duke influencuar ndjeshem ne rritjen e ndergjegjesimit te shoqerise shqiptare per keto ceshtje.







TITULLI I PROJEKTIT

**SHERBIME MBESHTETESE PER NJEREZIT
ME AFTESI TE KUFIZUARA NE NEVOJE PER
KARRIKE ME RROTA NE SHQIPERI**

DONATORI: USAID

PERIUDHA E ZBATIMIT: JANAR 2005-JANAR 2006

BUXHETI: 100,351 EURO

Ne nje ceremoni te organizuar me 3 qershor 2005 ne ambientet e fabrikes Miresia, program i Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar, Znj. Marcie Ries, ambasadore e SHBA ne Shqiperi ne prezence te perfaqesuesve te larte te institucioneve shteterore, shoqerise civile dhe partnereve te tjere te FSHPAK lançoi mbeshtetjen qe Qeveria e SHBA permes fondit te Leahy War Victims Fund eshte duke i dhene FSHPAK per zbatimin e projektit “ Sherbime mbeshtetese per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi ne nevoje per karrike me rrota”. Ky projekt synon te rrishte numrin e personave me aftesi te kufizuar te cilet do te mund te perdorin mjete levizese ne funksion te shtimit te mundesive per integrim ne ambientin shoqeror ku jetojne.

Zhvillimi i aktiviteteve te projektit eshte fokusuar ne disa drejtime kryesore duke mundesuar arritjen e objektivave.

*Prodhimi i mjeteve levizese ne punishten “ Miresia “.
Punesim i 6 personave me aftesi te kufizuar*

Zbatimi i projektit ka ndikuar per te siguruar vazhdimesine e proçesit te prodhimit te mjeteve levizese ne fabriken Miresia. Projekti mbeshtet prodhimin e 13 karrikeve me rrota ne muaj , kapaciteti i plote i prodhimit te mjeteve levizese ne punishte eshte 30 karrike me rrota. FSHDPAK permes programeve te tij lobon per ngritje fondesh nga burime te tjera lokale, struktura shteterore dhe donatore te huaj me qellim plotesimin e kapacitetit te plote prodhues ne fabrike.

Karriket me rrota te prodhuara u jane shperndare personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi mbeshtetur ne planin e shpendarjes dhe listen e pritjes. Ne vijim paraqitet shperndarja sipas grupmohave, seksit dhe vendbanimeve.

Nr. i karrikeve me rrota te mbeshtetur nga USAID	Nr. i perfituesve	Meshkuj	Femra	Fëmijë
156	156	76	80	56

Perfituesit	Karrike te prodhuara	%
Female	80	51.2
Meshkuj	76	48.8
Te rinj	100	64.1
Femije	56	35.9
Zona Rurale	87	55.7
Zona Urbane	69	44.3

Karriket me rrota jane shperndare ne rajonet; Tirane, Elbasan, Berat, Lezhe, Durres, Lushnje, Laç, Vlore, Kuçove dhe Shkoder.

Gjithashtu mbeshtetja e proçesit te prodhimit ka influencuar edhe ne ofrimin e shanseve te integritimit per 6 persona me aftesi te kufizuar (2 prej tyre perdores te

karrikes me rrota) permes punesimit ne fabriken Miresia duke ndikuar drejtpersedrejti ne permiresimin e cilesise se jetes se tyre.

Ngritje e kapaciteteve te individeve me aftesi te kufizuar dhe aktoreve pergjegjes per kete problematike

Projekti ka ofruar informacion dhe trainime per personat me aftesi te kufizuar, familjare te tyre si dhe perfaqesues te strukturave shteterore me qellim ndergjegjesimin per problematiken e aftesise se kufizuar, nevojat e personave me aftesi te kufizuar, te drejtat e tyre duke krijuar me shume akses per te gjithe per tu informuar dhe marre mendimin e specializuar per çeshtjet e aftesise se kufizuar. Gjate vitit 2005 jane zhvilluar 4 trainime, 2 prej te cileve me individe ne aftesi te kufizuar, 1 me familjare te personave me aftesi te kufizuar dhe 1 trainim me perfaqesues te zyrave rajone te ndihmes dhe sherbimeve sociale (partnere ne identifikimin e PAK ne nevoje per mjete levizese dhe shperndarjen e tyre) nga te cilet kane perfituar njohuri 76 persona.

Gjithashtu projekti ka mbeshtetur trainimin e personave me aftesi te kufizuar, perfitues te karrikeve me rrota per perdorimin e karrikes me rrota, karrike e stilit aktiv. Per kete qellim nga 22 – 27 Tetor, 2005 ne kompleksin Mak Albania ne Durres eshte zhvilluar Kampi i Rehabilitimit Aktiv. Ne kete kamp kane marre pjese 37 persona me aftesi te kufizuar dhe familjare te tyre. Trainimi eshte drejtuar nga specialiste, fizioterapiste te cilet i kane njohur personat me aftesi te kufizuar dhe familjaret e tyre me menyren e perdorimit te karrikes me rrota dhe kujdesin per veten. Gjithashtu fondacioni ka bere pjese te skuadres trainuese ne kete kamp edhe dy perdorues te karrikes me rrota te cilet prej vitesh jane perdorues aktiv te saj duke ndare me pjesemarresit eksperieca te jetes se tyre. Pjesemarresit kane perfituar gjate kesaj periu dhe keshillime dhe orientime nga specialiste, juriste dhe punonjes sociale.

Ndergjegjesim per te drejtat e personave me aftesi te kufizuar permes informimit

Zbatimi i projektit ka synuar te rrise nivelin e ndergjegjesimit te aktoreve pergjegjes dhe opinionit publik me gjere per problematiken e aftesise se kufizuar ne Shqiperi duke synuar ndryshim dhe permiresim te qendrimeve te tyre kundrejt kesaj kategorie.

Projekti e ka realizuar kete permes avokatise se zhvilluar ne vazhdimesi me perfshirjen edhe te personave me aftesi te kufizuar duke kerkuar mbrojtje dhe respektim te te drejtave te tyre. Projekti ka mbeshtetur kete qellim edhe permes

organizimit te diteve informuese te cilat jane zhvilluar ne kuader te 3 dhjetorit, dites nderkombetare te aftesise se kufizuar ne 3 qytete, Tirane, Shkoder dhe Elbasan. Gjate aktivitetit jane shperndare ne institucione shteterore dhe ambiente te tjera publike materiale informative, publikime, flete informuese, postera duke dhene mesazhe te njohjes dhe respektimit te te drejtave te personave me aftesi te kufizuar.

Ketij qellimi i ka sherbyer pregatitja dhe shfaqja e nje spoti dhe e nje dokumentari te cilat kane evidentuar situaten e personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi si dhe kane qene apel per njohje dhe respektim te te drejtave te tyre nga shoqeria shqiptare.

Publikime per aftesine e kufizuar

Per informimin e individeve me aftesi te kufizuar dhe aktoreve pergjegjes per problematiken e aftesise se kufizuar krahas botimeve ekzistuese te FSHDPAK projekti ka mbeshtur edhe publikimin e:

1. 5 flete informacioni

- Praplegjia dhe Tetraplegjia
- Distrofia Muskulare
- Post polio Sindrome
- Ç' eshte terapia dhe cilat jane disa nga llojet e terapise ne paralizen cerebrale infantile
- Spina Bifida

2. 1 Manual udhezues te perdorimit te karrikeve me rrota

3. 1 liber me histori jetesore te personave me aftesi te kufizuar “ Nje enderr qe nuk kisha guximin ta enderroja”.

Avokati dhe lobim per te drejtat e personave me aftesi te kufizuar, perdorues te mjeteve levizese

Projekti ka synuar gjithashtu permes avokatise dhe lobimit te rrise vemendjen dhe angazhimin e institucioneve pergjegjese per respektimin dhe zbatimin e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar, perdorues te karrikeve me rrota. Gjate aplikimit te projektit eshte synuar ndergjegjesim permes avokatise per zbatim te “Normave Urbanistike dhe

Arkitektonike per Personat me Aftesi te Kufizuar”, per me shume ambiente te pershtatura per personat me aftesi te kufizuar, perdorues te karrikeve me rrota.

Avokatia eshte realizuar edhe ne drejtim te aktivizimit te burimeve lokale publike dhe private per te mbeshtetur prodhimin e mjeteve levizese ne punishte .

Projekti “ Sherbime mbeshtetese per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi ne nevoje per karrike me rrota” i mbeshtetur nga Leahy War Victims Fund, permes USAID – Shqiperi eshte nje nder projektet me konkrete dhe komplekse ne mbeshtetje te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi per tu integruar si te barabarte ne shoqeri.



Burime te tjera lokale te cilat kane mbeshtetur dhe siguruar qendreshmerine e aktivitetit te punishtes “Miresia”

PERIUDHA : JANAR 2005-JANAR 2006
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE (ISSH)

Ministria e Punes Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta permes ISSH bazuar ne V.K.M. nr.381, date 20.05.1996 per zbatimin e ligjit nr. 7889, date 14.12.1994 “ Per statusin e invalidit “, ka mbeshtetur me nje fond akorduar nga buxheti i shtetit prodhimin e 200 karrikeve me rrota per invalide te punes, pjese te skemave te ISSH.

FSHDPAK ka bashkepunuar ngushtesisht me ISSH dhe 12 Zyrat Rajonale te ISSH per koordinimin e shperndarjes se mjeteve levizese tek individet ne nevoje. Kjo mbeshtetje e strukturave shtetore ka qene rezultat i avokatise se vazhdueshme te FSHDPAK per te krijuar qendrueshmerine e projektit nga burime lokale.

Spitalet Rajonale Durres dhe Berat kane porositur ne shumen 300.000 leke secili, prodhimin ne punishten « Miresia » te pajisjeve spitalore.

VODAFONE

Vodafone- Foundation permes Vodafone – Shqiperi nga mbeshtetur prodhimin e 30 karrikeve me rota per persona me aftesi te kufizuar ne rajonet: Laç dhe Lezhe.

Edhe kjo mbeshtetje eshte rezultat i ndergjegjesimit te bere nga FSHDPAK bizneseve shqiptare dhe te huaja per nevojat e personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi. Mbeshtetja e dhene ne vazhdimesi nga VODAFONE ka garantuar vazhdimesine e prodhimit te mjeteve levizese dhe punesimit te 6 PAK ne punishte si dhe deshmon per aktivizimin e biznesit serioz ne mbeshtetje te grupeve vulnerable te shoqerise shqiptare.

WORLD VISION ka mbeshtetur prodhimin e 19 karrikeve me rota.

Aeroporti i Tiranes ka mbeshtetur prodhimin e 8 karrikeve me rota.





TITULLI I PROJEKTIT

**PER NJE ROL ME AKTIV TE SHOQERISE
CIVILE NE ZBATIMIN E SKAK.**

PERIUDHA E ZBATIMIT: 25 /11/2004 - 25/11/2005

DONATOR:FONDACIONI I SHOQERISE SE HAPUR PER SHQIPERINE

BUXHETI: 16,318 EURO

FSHDPAK, si organizate promotore per hartimin dhe aprovimin e SKPAK, permes nje granti te ofruar nga Fondacioni i Shoqerise se Hapur per Shqiperine, gjate vitit 2005 vazhdoi te luaje nje rol nismetar, tashme per nxitjen e implementimit te saj.

Ne kuadrin e projektit “Per nje rol me aktiv te shoqerise civile ne zbatimin e SKAK, gjate vitit 2005 u zhvilluan aktivitetet si me poshte:

1. U organizuan 8 seminare njohese & ndergjegjesuese mbi SKAK ne rajonet Tirane, Dures, Elbasan, Shkoder, Lezhe, Berat, Korce dhe Vlore.

Seminaret synuan ne krijimin e partneriteteve midis OJFve te sferes se aftesise se kufizuar dhe strukturava pergjegjese per problematiken e aftesise se kufizuar ne nivel lokal e rajonal. Ne to morren pjese 233 perfaqesues te pushtetit lokal dhe organizatave lokale te aftesise se kufizuar.

2. Nje cikel prej kater trajnimesh u realizua me synimin e nxitjes se avokatisve ne nivel lokal ne drejtim te respektimit te drejtave te personave me aftesi te kufizuar. Ne trajnimet e organizuara ne qytetet Elbasan, Shkoder, Pogradec dhe Tirane, morren pjese 60 perfaqses te organizatave te spektrit te aftesise se kufizuar.
3. Materiale informative te nevojshme per ndergjegjesim dhe njohje te strategjise kombetare jo vetem nga strukturat pergjegjese por nga gjithë komuniteti, jane pergatituar ne kuadrin e ketij projekti. Perkatesisht u pergatiten dhe u botuan flete informative dhe poster, te cilat u shperndane gjate aktiviteteve te realizuara ne kuadrin e projektit.
4. Ne 3 Dhjetor, Diten Nderkombetare te AK, u organizua nje dite informacioni, jo vetem ne Tirane por edhe ne rrethe si Pogradeci, Elbasani, Shkodra. Qellimi ishte ndergjegjesimi ne nivel kombetar per te Drejtat e PAK, menyren se si gjejne shprehje keto te drejta ne SKAK, njohja e dokumentit te SKAK, thirrje per zbatimin e saj. Dita e informacionit u shoqerua me shperndarje te materialeve si fletpalosje, postera, flete informacioni.

Po me synimi ndergjegjesimin ne nje shkalle me te gjere te gjithë komunitetit ne menyre te vecante per Strategjine Kombetare per PAK, rolin dhe pergjegjesite e gjithë aktoreve, ne menyre te vecante pushtetit qendror dhe lokal, shoqerise civile, por edhe gjithë komunitetit per te permbushur objektivat dhe masat konkrete qe realizojne gjithëperفشirjen dhe trajtim te barabarte ne komunitet per te gjithë njerezit me aftesi te kufizuar dhe familjaret e tyre, ne kuadrin e ketij programi u organizuan dhe u zhvilluan dy emisione-debat televiz ne televizionin “etv“, dhe ne TVSH. Te dy programet, paten te ftuar perfaqses nga gjithë aktoret e perفشire ne hartimin por dhe pergegjes per zbatimin e Strategjise Kombetare te AK.

Ky program, hodhi nje hap te pare dhe te rëndesishem per vazhdimesine e procesit te implementimit te Strategjise Kombetare te AK, zbatimi i stragjise kombetare te aftesise se kufizuar do te mbetet prioritet ne programet e FSHDPAK.



TITULLI I PROJEKTIT

PJESËMARRJA NË PROÇESET ZGJEDHORE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

PERIUDHA E ZBATIMIT: SHTATOR 2004 – QERSHOR 2005

DONATOR: AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË TIRANË

BUXHETI: 19,463 EURO

Proçesi i filluar nga FSHDPAK në fillimet e 2001, për mbrojtjen, zbatimin dhe përmirësimin e të drejtës elektorale për personat me aftësi të kufizuar, vijoi në 2005 edhe me dy projekte.

Projekti “Pjesëmarrja në proçeset zgjedhore e Personave me Aftësi të Kufizuar”, i mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë , fokusohej në:

- Evidentimin e situates për zbatimin e ligjit egzistues elektorale për pjesëmarrjen e PAK në votime.
- Përcaktimin e mënyrave dhe mjeteve për mundësimin e votimit për PAK që nuk ushtrojnë dot votimin e drejtpërdrejtë e të fshehtë.

Evidentimi i situates për zbatimin e ligjit egzistues elektoral për PAK

U realizua evidentimi i situates për zbatimin e ligjit egzistues elektoral për PAK nëpërmjet sondazhit të bërë në 4 qytete - Tiranë, Elbasan, Pogradec e Librazhd, në bashkëpunim me Pushtetin Vendor dhe nga 800 intervistat e drejtpërdrejta, bazuar në pyetësorët e parapërgatitur, me zgjedhës më aftësi të kufizuar që nuk shkojnë dot në qendrat e votimit.

U organizua një seminar ku u diskutua mbi të dhënat e sondazhit. Mbi bazën e të dhënave të sondazhit dhe konkluzioneve të seminarit u përgatit dhe u botua e u shpërnda studimi “Pjesëmarrja në proceset zgjedhore e personave me aftësi të kufizuar”.

Përcaktimi i mënyrave dhe mjeteve për mundësimin e votimit për PAK që nuk ushtrojnë dot votimin e drejtpërdrejtë e të fshehtë

1. U punua për identifikimin dhe rregjistrimin parazgjedhor të zgjedhësve AK nëpërmjet takimeve e kontakteve të vazhdueshme, korespondences me institucionet përkatëse të të gjitha niveleve (KQZ, Ministria e Pushtetit Vendor) si dhe përgatitjes dhe shpërndarjes së posterave, fletë palosjeve si dhe përgatitjes dhe shfaqjes së një spoti televiziv.
2. U përgatitën Standartet e Pershtatshmërisë për përzgjedhjen e qendrave të votimit të cilat u bënë prezente dhe u diskutuan ne një seminar dhe broshura “Standartet e Pershtatshmërisë për Qendrat e Votimit” u botua dhe u shpërnda pranë njësive të pushtetit vendor.;
3. u modelua dosja ndihmëse për votimin e të verbërve;
4. u modeluan dhomat e fshehta të përshtatura.

Në kuadrin e ngritjes së kapaciteteve u zhvilluan trajnime për koordinatörë, për 40 trajnerë të trajnimit të komisionerëve vendorë si dhe 3 trajnime për votuesit me aftësi të kufizuara dhe shoqatat e tyre, me 42 pjesëmarrës, në 3 qytetet e pilotuara.



TITULLI I PROJEKTIT

**PROCESI I VËZHGIMIT ZGJEDHOR NGA
ZGJEDHËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

PERIUDHA E ZBATIMIT: 15 PRILL – 15 GUSHT 2005

DONATOR: USAID /DGA, PERMES PARTNERËT – SHQIPËRI, “QËNDRA PËR
NDRYSHIM DHE MENAZHIMIN E KONFLIKTEVE”

BUXHETI: 14,483 EURO

Qëllimi i këtij projekti ishte vlerësimi, nëpërmjet procesit të vëzhgimit, i nevojave për reforma zgjedhore për votimin e PAK që nuk shkojnë dot në qendrën e votimit, si edhe votuesve të tjere me AK.

Fushat e ndërhyrjes permes aktiviteteve te realizuara :

Bashkëpunim dhe ngritje kapacitetesh

Një nivel më i lartë bashkëpunimi u realizua me KQZ dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor nëpërmjet shumë takimeve dhe korespondencave, për të nxitur zbatimin e legjislacionit për procesin e evidentimit të zgjedhësve me AK, procesin e finalizimit dhe përdorimit të mjeteve të posaçme për të verbërit, të dhomave të fshehta të përshtatura si dhe të një mjedisi në tërësi të përshtatur

U zhvilluan 3 trajnime për 66 vëzhguesit me aftësi të kufizuara, të cilët u pajisën me njohuritë dhe me mjetet e vëzhgimit.

Vëzhgim parazgjedhor

U zhvillua fushata ndërgjegjësuere parazgjedhore, me subjektet elektorale, e cila u pasqyrua në tre kronika televizive, si dhe u përgatitën dhe u shpërndanë një poster dhe një fletë-palosje, u përgatitën dhe u shfaqën dy spote televizive para zgjedhore (për herë të parë njeri i shoqëruar edhe me gjuhen e shenjave).

Vëzhgim ditën e votimit

U realizua procesi i vëzhgimit në qytetet Tiranë, Elbasan e Librazhd nga grupi i 66 vëzhguesve me AK. U monitorua pjesëmarrja e zgjedhësve AK në votime që rezultonte në shifra shumë të ulta; u monitorua niveli i përshtatshmërisë së qendrave të votimit; u monitorua përdorimi i dhomave të fshehta të përshtatura; përdorimi i mjeteve të posacme të përdorura për herë të parë nga të verbërit.

Procesi i vëzhgimit gjatë ditës së votimit u pasqyrua nëpërmjet tre kronikave TV dhe dy artikuj gazetash. Realizimi i një dokumentari pasqyroi përfshirjen në proceset zgjedhore të zgjedhësve AK.

Perpunim i te dhenave te vëzhgimit , hartim/publikim dhe shpërndarja e raportit final

Hartimi i një raporti final me rezultatet e vëzhgimit u prezantua në një konferencë për shtyp, ku morën pjesë përfaqësues të 10 mediave kryesore, elektronike dhe të shkruar, dhe u shpërnda në të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare si edhe të gjitha institucioneve përgjegjëse.


Arritjet positive të të dy projekteve patën në bazë dialogun konstruktiv ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile. Edhe pse në Shqipëri ka klimë positive për të respektuar të drejtën e votes për zgjedhësit me AK, mbetet ende shume për të bërë që ky process të jetë i vazhdueshëm dhe progresiv për të realizuar që asnjë zgjedhës me aftësi të kufizuar të mos mbetet pa votuar.



PUBLIKIME TE FSHDPAK QENDRA BURIMORE E AFTËSISË SË KUFIZUAR

Janar 2005 - Dhjetor 2005

- 1- Standardet dhe Përshtatshmëri në qendrat e votimit.
- 2- Libër Udhëzues për të përdorur normat e urbanistikës dhe arkitektonikës për personat me aftësi të kufizuara.
- 3- Raport për një sondazh të bazuar në familje 'Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në procesin e zgjedhjeve'.
- 4- Raport 'Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005 nga personat me aftësi të kufizuara'
- 5- Raport kërkimor 'Analiza e kuadrit ligjor që garanton arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara sipas arsimit përfshirës'.
- 6- Azhurnimi dhe ribotimi i Paketës së Legjislacionit shqiptar për aftësinë e kufizuar.
- 7- Libërth udhëzues për Ligjin Nr. 7703, 'Për Sigurimet Shoqërore'
- 8- Libërth udhëzues për Ligjin Nr. 7889 'Për Statusin e Invalidëve të Punës'.
- 9- Ribotimi i manualit për karrigen me rrota të 'Mirësisë'
- 10- Paketa e Informacionit për të ndihmuar prindërit që të rritin një fëmijë me aftësi të kufizuara.
- 11- Paketa e Informacionit për të ndihmuar mësuesit për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- 12- "Një ëndërr që nuk kisha patur guximin ta ëndërroja", libër me histori reale jetësore të njerëzve me aftësi të kufizuara dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre.
- 13- "Aftësia e Kufizuar dhe Barazia" Manual Trajnimi.



Informacion Financiar

Lista e projekteve dhe donatoreve te FSHDPAK gjatë vitit 2005

TITULLI I PROJEKTIT	Donoret	Data e fillimit dhe perfundimit te kontrates	Buxheti i aprovuar	Shpenzimet 1 Mars 05-31 Dhjetor 05
DISABILITY RESOURCE CENTER				
	Cordaid		Euro 90,053.81	83,276.97
	Komitetei Suedez I Helsinkit per te Drejttat e Njeriut (Media dhe AK)	01/01/05-31/12/05	Euro 34,915.06	34,987.00
	Komitetei Suedez I Helsinkit per te Drejttat e Njeriut (Asistence ligjore dhe avokat falas per PAK)	01/01/05-31/12/05	Euro 29,920.06	27,042.00
	Ambasada Amerikane (Akses electoral per PAK)	25/09/04-01/06/05	Euro 19,463	8,366.46
	Soros (Per nje rol me aktiv te shoqerise civile)	25/11/04-25/11/05	Euro 15,804	16,318.82
	USAID/DGA/Partners Albania (Vezhgimi I procesit zgjedhor nga PAK)	01/04/05-01/08/05	Euro 14,425, 5	14,483.66
	Balance nga viti 2004		1380	3,513.35
TOTALI			205, 966	187,988.26
FABRIKA PER PRODHIMIN E KARRIKEVE ME RROTA DHE OFRIMIN E SHERBIMEVE TE TJERA MBESHTESE PER PAK				
	Balance nga viti 2004		Euro 33,341	
	Novib	Janar 05-Dhjetor 05	Euro 74,571	
	USAID	Shtator 04-Mars05	Euro 39, 172	
		Mars 05-Mars 06	Euro 100,351.75	
	Instituti i Sigurimeve Shoqerore	2005	Euro 40,635	
	Berat Hospital	2005	Euro 4,880	
	OSU Tirana	2005	Euro 2,447	
	Aeroporti Tiranë		Euro 1,218	
	World Vison		Euro 3,865	
	Kontributi I klienteve		Euro 842.88	
	Shitje e patericave		Euro 131.53	
	Shitje e produkteve te tjera		Euro 1,852.85	
TOTALI			Euro 303,305	Euro 194,489.35



“INTER B.B.K.-Auditing” sh.p.k.

AUDITOR'S REPORT

**To the Executive Manager of the Association
Albanian Disability Rights – Tirana Albania**

Project number: 432/10033

1. We have audited the accompanying statement of income and expenditures of Albanian Disability Rights - Albania (the Organization) for the period 1 March 2005 to 31 December 2005 related to the project Disability Recourse Center (the Project) pursuant to the “Contract for Financing of the Project” (the Contract), between the Organization and CORDAID (the grantor), dated March 8, 2005. This statement is the responsibility of the Organization's management. Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit.
2. We have conducted our audit in accordance with International Standards of Auditing. Those standards require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the statement is free of material misstatement. An audit includes examining, on test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the statement. An audit includes also assessing the accounting principles used and significant estimates made by the management, as well as evaluating the overall statement presentation. We believe that our audit provides a reasonable basis on our opinion.
3. The Organization's policy is to prepare the statement of income and expenditures on the cash modified basis. On this basis, revenue is recognized when received rather than earned and expenses are recognized when paid rather than when incurred.
4. In our opinion, had we been able to satisfy ourselves on the balance of cash pertaining to the Project at 31 December 2005, as discussed, the accompanying statement of income and expenditures referred to above presents a true and fair view, in all materials respects, the revenue collected and the expenses paid by the Organization relative to the project "Disability Recourse Center" in accordance with the cash receipt and disbursement basis as described above.

“Inter BBK – Auditing” limited

Tirana July 31st, 2006

Esmeralda BALLUKU

Struktura vendimarrëse dhe administrative

Bordi

1- Arjana Haxhiu	Presidente
2- Gezim Tushi	anetar
3-Virgjil Nano	anetar
4- Elza Xha	anetar
5- Mimoza Bezhani	anetar

Stafi ekzekutiv

1. Blerta CANI	Drejtores ekzekutive
2. Aferdita Dalla	Finance Officer
3. Sajmir Grumbleshi	Shofer/ punonjes logjistike
4. Florida Kalemi	Koordinatorë programi
5. Bardhylka Kospiri	Koordinatorë programi/ avokati, kohe te pjesshme
6. Narbis Ballhysa	Koordinatorë programi
7. Entila Zyba	Koordinatorë programi, juriste avokate
8. Eri Shtino	Asistente, juriste, kohe te pjesshme
9. Harlisa Domi	Juriste , Durres/ kohe te pjesshme
10. Fatmira Caci	Juriste, Vlore/ kohe te pjesshme
11. Luiza Popja	Juriste, Elbasan/ kohe te pjesshme
12. Ornela Beqo	Juriste, Korçe/ kohe te pjesshme
13. Yllka Rupa	Juriste, Shkoder/ kohe te pjesshme

Fabrika Miresia

1- Pilo Miho	Ing, manaxher
2- Zamira Mula,	Koordinator, Miresia
3- Zija Kulla	Teknik/ part time
4- Qederim Hysenaj	Teknik/ part time
5- Ruzhdi Pasholli	Teknik/ part time
6- Anife Ramaliu	rrobaqepese/part time
7- Mustafa Nano	Teknik
8- Halil Greca	Teknik
9- Petrit Kaziu	Teknik/shofer Miresia
10- Agron Paco	Teknik
11- Llazar Ristani	Teknik
14 Femra	10 meshkuj

PLANIFIKIMI STRATEGJIK I FSHDPAK

2006-2009

NGA MISIONI TEK DREJTIMET STRATEGJIKE

Shqetësimet kryesore që lidhen me fushat e ndërhyrjes së FSHDPAK	Drejtimet strategjike të FSHDPAK	Qëllimet strategjike organizative
<p>- Mungesa e aksesit në sistemin e drejtësisë/ne informacion dhe ndihme ligjore për PAK dhe pjesëtarët e familjes së tyre.</p>	<p>Promovimi i shtetit ligjor dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore të PAK</p>	<p>1.1 – Ofrimi i këshillimit/orientimit ligjor dhe avokati të çështjeve në gjyq duke ndihmuar rreth 1200 PAK dhe familjet e tyre me të gjitha çështjet ligjore që lidhen me aftësinë e kufizuar (400/ne vit/përparësi PAK intelektuale).</p>
<p>- Mangësi/moszbatimi i kuadrit ligjor shqiptar që garanton të drejtat e PAK.</p>		<p>1.2 – Ndërmarrja e lobingut dhe iniciativës së avokatisë për përmirësimin dhe zbatimin e legjislativon që lidhet me të drejtat qytetare, ekonomike dhe kulturore të PAK/ fokusimi tek ligji për shanset e barabarta (mosdiskriminimi dhe ndjeshmëria gjinore midis grupeve të ndryshme të PAK për të zhdukur diskriminimin në mënyrë të veçantë të PAK intelektuale për të cilët kujdesi është me i pakti, zhdukja e diskriminimit që ekziston mes njerëzve me AK dhe atyre pa AK)</p> <p>* përpjekje të vazhdueshme avokatie të fushave të targetuara të FSHDPAK (pershtatshmeria/ arsimimi/ punësimi/aksesi zgjedhor/</p> <p>* përpjekje të vazhdueshme avokatie për të siguruar pjesëmarrjen e PAK në diskutimet për Konventën e OKB për mbrojtjen e të drejtave të PAK dhe garantimin nga Qeveria shqiptare që jo vetëm të përfshihet në hartimin e saj por edhe ta ratifikojë atë.</p>
<p>- Mungesa e strukturave dhe sistemeve monitoruese për ta bërë Qeverinë shqiptare përgjegjëse për zbatimin e politikave kombëtare për aftësinë e kufizuar.</p>	<p>Promovimi qeverisjes së mirë që trajton çështjet e PAK</p>	<p>1.3 – Krijimi i një sistemi monitorues dhe garantimi i raporteve vjetore hije/alternative për Barazimin e shanseve për PAK siç deklarohet në Strategjinë Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar miratuar nga Qeveria shqiptare në Janar 2005. Monitorimi i veçantë dhe raportet do të shkruhen gjithashtu për PAK intelektuale duke qenë me të diskriminuarit dhe ato do të inkuorohen në raportet e përgjithshme për shanset e barabarta PAK)</p>

<p>- Mungesa e shanseve te punësimit për PAK</p> <p>- 60% e PAK mbështeten ne te ardhura shume te pakta.</p> <p>- 9000 njerëz kane nevojë për mjete lëvizëse/ - politika te pamjaftueshme subvencionimi nga ana e Qeverise shqiptare dhe komuniteteve te tjere</p>	<p>Mbështetje dhe shërbime sociale për PAK</p>	<p>2.1 Përmirësimi i integritit social dhe nivelit ekonomik te PAK nëpërmjet shanseve te punësimit te ofruara nga punishtja 'Mirësia' e FSHDPAK</p> <p>2.2 Sigurimi qe PAK te furnizohen me mjete lëvizëse, prodhime te punishtes 'Mirësia'</p> <p>2.3 Sigurimi i vazhdimësisë se aktivitetit prodhues se punishtes nëpërmjet subvencionimit te siguruar nga burime te ndryshme, kryesisht nga Qeveria shqiptare si pjese e politikave te saj sociale.</p>
<p>- Diskriminimi dhe izolimi/institucionalizimi i PAK, kryesisht i atyre me aftësi te kufizuar mendore ose te shumëfishte</p> <p>- Mungesa e kapaciteteve midis vete njerëzve me aftësi te kufizuara/anëtarëve te familjes/zyrtareve përgjegjës qeveritare</p> <p>- Mungesa e mbështetjes se familjes dhe shërbimeve te tjera mbështetëse te domosdoshme për sigurimin e pjesëmarrjes se PAK</p> <p>- Familje te mbingarkuara dhe te dërmuara nga puna dhe avokati e pamjaftueshme për te drejtat e njerëzve me aftësi te kufizuara intelektuale.</p> <p>- Politika shtetërore te pamjaftueshme dhe praktika pozitive për njerëzit me aftësi te kufizuar intelektuale gjithashtu te pamjaftueshme</p>	<p>Kujdesi komunitar, fuqizimi dhe pjesëmarrja e komunitetit te PAK (përparësi u jepet njerëzve me aftësi te kufizuara intelektuale)</p>	<p>3.1 – Zgjerimi i rolit te Qendrës për Burimet për Aftësinë e Kufizuar ne Qendrën për Zgjerimin e Shanseve te Përfshirjes (CDIO), dhe përsëritja e saj ne te paktën tre zona te tjera te vendit.</p> <p>3.2 – Përmirësimi i aftësisë te PAK / anëtarëve te familjes dhe te gjithë aktoreve kryesore përmes trajnimit /këshillimit /ekspertizës.</p> <p>3.3 – Sigurimi i avokatisë / mbështetjes për familjen/mbështetje për shkollën/mbështetje për punësim dhe mbështetje e pjesëmarrjes se komunitetit me një qasje te menaxhimit te çështjes për një total prej 360 njerëzish me aftësi te kufizuar (40 çështje për rreth x 3 rrethe x 3 vite). Përdoret një qasje rast pas rasti.</p> <p>3.4 – Krijimi i rrjetit te avokatisë se prindërve ne nivel vendor dhe përfshirja e tyre ne proceset e vendimmarrjes për njerëzit me aftësi te kufizuara intelektuale.</p> <p>3.5- Zhvillimi i avokatisë efçente ne mënyrë qe te ndikohet ne politikat dhe praktikat qeveritare për te përfutur njerëzit me aftësi te kufizuara mendore dhe intelektuale. Përdorimi i përpjekjeve monitoruese te FSHDPAK (1.3) për te vene ne pah dhe për te pasur si përparësi në programet qeveritare njerëzit me aftësi te kufizuara mendore dhe intelektuale.</p>
<p>PAK janë akoma te padukshëm për shkak te një sere barrierash fizike dhe psikologjike qe kulmojnë ne perceptimet kulturore dhe qëndrimore qe kufizojnë rreptësisht aksesin e tyre ne jetën e pergjithshme.</p> <p>- Kjo inkurajon mungesën e imazheve pozitive te njerëzve me aftësi te kufizuar gjë qe çon ne një marginalizim dhe diskriminim te mëtejshëm.</p>	<p>Edukimi Qytetar/ Ndërgjegjësimi Publik</p>	<p>4- Përdorimi i çdo shansi për te kërkuar publicitet dhe ndërgjegjësim për te ndryshuar imazhet negative për njerëzit me aftësi te kufizuara duke i kushtuar vëmendje te veçante evidentimit te pozicionit te njerëzve me aftësi te kufizuara mendore dhe intelektuale dhe grave me aftësi te kufizuara, ne mënyrë qe brezat e ardhshëm t'i pranojnë njerëzit me aftësi te kufizuara si pjesëtarë te barabarte ne shoqëri.</p>
<p>- Mbështetja e donatoreve për aktivitetin e OJQ-ve ne Shqipëri ne rënie</p> <p>- Aktiviteti i FSHDPAK mbështetet ne financimin e donatoreve/financimet e Qeverise vetëm fragmentare</p>	<p>Sigurimi i mbështetjes se domosdoshme financiare për zbatimin e qëllimeve strategjike te organizatës</p>	<p>5.1 – Rritja e kapaciteteve te FSHDPAK ne mënyrë qe te rritet cilësia e shërbimeve.</p> <p>5.2 – Zhvillimi i marketingut dhe mundësia e gjetjes se fondeve për FSHDPAK.</p> <p>5.3 – Zhvillimi i Mirësia si je biznes social qe ka për synim mes te tjerash dhe një program gjenerimi te ardhurash për FSHDPAK.</p>